

Termt e Referencës: “Ekspert për Krijimin e një Protokolli Monitorimi për *Salmo letnica* në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit-PMTULP”, për AdZM Korçë, aktiviteti 2.3

1. Hyrje

Liqeni i Pogradecit (PMTULP) është një ekosistem unik dhe i mbrojtur, i njohur për biodiversitetin e tij të pasur dhe veçanërisht për praninë e *Salmo letnica* (korani i Ohrit), një specie endemike me rëndësi të lartë ekologjike dhe ekonomike. Ndryshimet mjedisore, ndotja dhe aktivitetet antropogjene kanë ndikuar në popullatën e kësaj speciejë, duke e bërë të domosdoshme krijimin e një protokolli të qartë monitorimi për të vlerësuar gjendjen e saj dhe për të zbatuar masa menaxheriale të përshtatshme për mbrojtjen e saj.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Peisazh i Mbrojtur Tokësor-Ujor i Liqenit të Pogradecit-PMTULP (PA_025), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, si rrjedhim kërkon për një ekspert që do të hartojë një protokoll monitorimi për *Salmo letnica* në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit-PMTULP.

Ky protokoll do të ndihmojë Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Korçë dhe institucionet përgjegjëse të kenë një metodologji standarde për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi popullatën e *Salmo letnica*, faktorët që ndikojnë mbi të dhe tendencat afatgjata të ndryshimeve në ekosistem tek PMTULP.

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të hartojë një protokoll të detajuar monitorimi për *Salmo letnica*, duke përcaktuar metodat, frekuencën dhe indikatorët kryesorë për vlerësimin e statusit të popullatës dhe faktorëve ndikues në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit (PMTULP).
- b. Ky Protokoll monitorimi do të shërbejë si bazë për Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Korçë dhe institucionet përgjegjëse **për menaxhimin e qëndrueshëm të species dhe për përmirësimin e masave të ruajtjes, duke përfshirë rekomandime për institucione dhe aktorë lokalë**, me anë të një metodologjie standarde për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi popullatën e *Salmo letnica*, faktorët që ndikojnë mbi të dhe tendencat afatgjata të ndryshimeve në ekosistem tek PMTULP.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Peisazhi i Mbrojtur Tokësor-Ujor i Liqenit të Pogradecit-PMTULP sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për Krijimin e një Protokolli Monitorimi për

Salmo letnica në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit-PMTULP” për AdZM Korçë lidhur me PMTULP.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për raportin e detajuar që do të hartojë:

- *Analizë të situatës aktuale:* Vlerësimi i popullatës aktuale të *Salmo letnica* në PMTULP, bazuar në të dhënat ekzistuese dhe faktorët mjedisorë që ndikojnë në dinamikën e saj.
- *Identifikim të metodologjive më të mira të monitorimit:* Përzgjedhja e teknikave të përshtatshme për monitorimin e specieve, duke përfshirë metoda biologjike, ekologjike.
- *Përcaktim të frekuencës dhe vendndodhjeve të monitorimit:* Caktimi i periudhave të monitorimit, numrit të mostrave dhe zonave kyçe në PMTULP për mbledhjen e të dhënave.
- *Hartim të indikatorëve biologjikë dhe ekologjikë:* Identifikimi i treguesve për vlerësimin e shëndetit të popullatës dhe ekosistemit (p.sh. madhësia e popullatës, struktura e moshës, kushtet ujore dhe ndikimet antropogjene).
- *Rekomandime për masat e menaxhimit:* Propozime për përmirësimin e politikave të mbrojtjes, reduktimin e faktorëve të rrezikut dhe përfshirjen e institucioneve dhe komuniteteve në procesin e ruajtjes së *Salmo letnica* tek PMTULP.
- *Udhëzime për zbatimin e protokollit:* Përshkrimi i hapave për aplikimin praktik të metodologjisë (Protokolli i Monitorimit për *Salmo letnica* në PMTULP) nga stafet e institucioneve të menaxhimit dhe kërkuesit shkencorë.
- *Produkti final (Raporti strategjik) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në biologji, peshkim dhe akuakulturë, shkenca mjedisore ose fusha të ngjashme.
- Eksperiencë të paktën 5-vjeçare në monitorimin e ekosistemeve ujore, me fokus në speciet e peshqve të ujërave të ëmbla.
- Njohuri mbi metodat moderne të monitorimit të peshqve.
- Aftësi të shkëlqyera për përgatitjen e dokumenteve teknike dhe strategjike.
- Njohuri të mira mbi kuadrin ligjor për mbrojtjen e biodiversitetit në Shqipëri dhe BE.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për Krijimin e një Protokollit Monitorimi për *Salmo letnica* në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit-PMTULP” për AdZM Korçë lidhur me PMTULP.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PMTULP, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 2.3 me objekt "Ekspert për Krijimin e një Protokolli Monitorimi për *Salmo letnica* në Peizazhin e Mbrojtur Tokësor-Ujor të Liqenit të Pogradecit-PMTULP" për AdZM Korçë lidhur me PMTULP, **parashikuar në vlerën maksimale 5,000 (pesë mijë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).